



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

**Programi i punës praktike në Qendren për Zhvillim të Karrierës**

Të nderuar studentë, ftoheni të aplikoni në programin e punës praktike të Qendres për Zhvillim të Karrierës në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

\* \* \*

E organizuar nga: Zyra për Zhvillim Akademik - Qendra për Zhvillim të Karrierës – ZZhA / QZhK –  
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

**Misioni i QZhK-së, është t'u ofrojë studentëve mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit, ndërmjetësimit më punëdhënësin, hartimit të dokumentëve profesionale në fushën e karrierës dhe udhëzimit në karrierë. Përfituesit e shërbimeve të QZHK-së janë: studentët dhe të diplomuarit e UP-së, nxënësit e shkollave të mesme të cilët kërkojnë mundësi studimi në Universitetin e Prishtinës, fakultetet, organizatat dhe punëdhënësit. Qëllimi kryesor i Qendrës për Zhvillim të Karrierës është përgatitja e studentëve dhe të diplomuarve për tregun e punës përmes këshillimit dhe trajnimeve si dhe informimi i tyre për mundësi të ndryshme të zhvillimit në karrierë.**

**Faqja Zyrtare:**  
<http://pvk.uni-pr.edu/>

**PUNË PRAKTIKE NË QENDREN PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS**

Afati i aplikimit: **2 DHJETOR 2015** deri me **15 DHJETOR 2015**

E hapur për studentë nga shkalla e studimeve, Bachelor ( Viti i studimeve ): **III** dhe Master ( Viti i studimeve ): **I dhe II**.

Puna praktike në QENDREN PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS: është **pa pagesë**.

**Cfarë ofron ky program:**

- Përfshirje në projekte konkrete;
- Kontratë mujore 3 + 3;
- Përfshirje në procesin e vlerësimit;
- Më të mirëve i ofrohet mundësia e ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve nga QZhK dhe MDA;

**Përshkrim i programit të punës praktike:**

I hapur për studentët e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultet: Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Filozofik, Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Arteve, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti i

Edukimit. 4h, angazhim profesional në 5 ditë të javës në KËNDET INFORMUESE TË QENDRES PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë për praktikantë**

- **Informimi i studentëve**

Selektimi i informates, pershtatja për targetin që perfaqeson informata dhe shperndarja e njoftimit përmes mekanizmave që aplikon QZhK.

- **Këshillimi i studentëve**

Ofrimi i informatave rreth pergaditjes së CV-së dhe LM-se. ( Asistimi në sesionet e Trajnimeve që ofron QZhK).

- **Regjistrimi në databazë i të dhënave të studentëve**

Pranimi i informatave nga studentët, regjistrimi i tyre në databazen QZhK, ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave.

- **Përkrahja në punë të tjera logjistike të Qendres për Zhvillim të Karrierës**

Praktikanti/ja do të ofrojë përkrahje në realizimin e aktiviteteteve të tjera të shprehura në planin dinamik të punës së Qendres për Zhvillim të Karrierës dhe punë të tjera të deleguara nga mbikqyrësi.

### **Informata rreth aftësive në punë:**

Praktikanti/ja preferohet të ketë:

Njohuri të avancuara në të folur dhe shkruar të Gjuhës Angleze;

Shkathtësi të komunikimit;

Aftësi të mira analitike;

Shkathtësi dhe njohuri në aplikimin e programeve kompjuterike nga pako Microsoft Office dhe shkathtësi në punë teknike;

Aftësi të punës në grup;

Motiv për t'u vetë zhvilluar dhe mësoni shpejt.

### **Informata rreth kriterëve të aplikimit:**

Procesi i angazhimit të praktikantëve, ofron mundësi të barabarta për të gjithë. Në anën tjetër, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, përmes Statutit dhe rregulloreve të brendshme është i perkushtuar të ofrojë mundësi të reja për studentet.

### **Si të aplikoni?**

Afati i fundit për aplikim është **15 DHJETOR 2015**. Aplikantët duhet të dorëzojnë **CV, LM dhe Certifikaten e notave**, (në Gjuhën Shqipe), në formatin elektronik pdf, në email adresen: [qzhk@uni-pr.edu](mailto:qzhk@uni-pr.edu)

### **Procesi i selektimit:**

Përzgjedhja në bazë të CV-së dhe LM-së

Intervistë me drejtuesit e Zyres për Zhvillim Akademik dhe Këshilltaret për Karrierë të QZhK-së **22DHJETOR 2015**

Testimi: PËR VLERËSIM TË NEVOJAVE

TRAJNIMI nga QZhK dhe MDA: **10 JANAR 2016**

Fillimi i programit për praktikant /internship: **15 JANAR 2016**.

Kandidatët e përzgjedhur do të thirren një për një në intervistë në ZZHA – QZhK, me **22 DHJETOR 2015**.

Praktikantët, në përfundim të programit të punës praktike, do të paisen me **Reference dhe Certifikat** nga: **Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”**.

**Praktikantët raportojnë dhe mbikqyren nga Këshilltaret për Karrierë të Qendres për Zhvillim të Karrierës**

**Këshilltari për Karrierë: Shkumbin Tafilaj**

Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Filozofik, Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit

**Këshilltarja për Karrierë: Elmedina Nikoçeviq – Kurti**

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Arteve, Fakulteti i Edukimit

Bazuar në Planin Startegjik të intervenimeve mbështetur nga MDA - Management Development Associates dhe projekti partner EYE - Enhancing Youth Employment , përfitues të fazes së parë do të jenë 26 studentë të cilet do të jenë të angazhuar në gjysme orari si praktikant në Këndet Informuese të Qendres për Zhvillim të Karrierës në njësitë përkatëse akademike.